


Ku ndryshon fiskalizimi me tvsh nga Fiskalizimi pa TVSH?

Biznes me TVSH	Biznes Pa TVSH
Xhiro Vjetore e Bisnesit në Shqipëri, kufiri për regjistrimin e biznesit për TVSH është 10,000,000 lekë (dhjetë milionë lekë) në vit (qarkullimi vjetor), që do të thotë se nëse biznesi ka një xhiro vjetore mbi këtë shumë, duhet të regjistrohet për TVSH.	Bizneset me xhiro nën kufirin e caktuar në Shqipëri 10,000,000 lekë nuk janë të detyruara të regjistrohen për TVSH dhe mund të qëndrojnë si biznese pa TVSH.
Biznesi me TVSH: Këto biznese janë të regjistruara në TVSH. Kjo do të thotë se atyre u kërkohet ligjërisht të ngarkojnë TVSH-në për mallrat ose shërbimet që u shesin klientëve.	Biznes pa TVSH: Këto biznese nuk janë të regjistruara në TVSH. Ata nuk ngarkojnë TVSH për shitjet e tyre dhe as nuk lejohen të kërkojnë TVSH për blerjet.
Biznesi me TVSH: Këto biznese duhet të dorëzojnë rregullisht deklaratat e TVSH-së pranë organeve tatimore. Ata raportojnë TVSH-në që kanë ngarkuar në shitje dhe TVSH-në që kanë paguar për blerjet.	Pa regjistrim të TVSH-së, bizneset nuk kanë nevojë të shqetësohen për ndjekjen e TVSH-së në shitje dhe blerje. Kjo mund të thjeshtojë kontabilitetin dhe të zvogëlojë barrën administrative
<i>Të gjithë subjektet që kryejnë importe janë të detyruara të deklarojnë TVSH-në, pavarësisht nga niveli i xhiros</i>	

Afati I fundit(për fiskalizim) sipas arsyes së vonesës në fiskalizim.

Në rast të ndërprerjes së lidhjes me internetin, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të informojë administratën tatimore brenda **48 orëve** përmes formularit "**Raportimi i pamundësisë së lidhjes me shërbimin fiskal**". Formulari dorëzohet elektronikisht në platformën qendrore të faturave ose personalisht në zyrën e administratës tatimore, nëse nuk mund të hyjë në platformë. Tatimpaguesi duhet të bashkangjitë dokumentacionin që vërteton arsyen e ndërprerjes së lidhjes me internetin. Nëse lidhja nuk rivendoset brenda **48 orëve**, mund të lëshojë fatura **pa NIVF** dhe fiskalizim deri në rivendosjen e lidhjes, dhe pas rifillimit të funksionimit, fiskalizon faturat offline. Nëse lidhja nuk rikthehet deri më **10-të të muajit pasardhës**, tatimpaguesi duhet të paraqesë të gjitha faturat e pafiskalizuara në administratën tatimore.



Në foton e mësipërme, jepet rasti kur një faturë është e pafisklizuar në programin Elif. Te lista e faturave të shitjes, kur ka fatura të cilat nuk janë fiskalizur shfaqet trekëndëshi në të majtë në fund të faqes. Klikoni te trekëndëshi, do ju shfaqet fatura e pafiskalizuar, klikohet një nga arsyet e mos fiskalizimit të faturës, më pasi i jep fiskalizo të gjitha.